



Viti i dhjetë i botimit, Mujore, Nr.2 (118) Shkurt 2009
 gazetamokra@yahoo.com Kryeredaktor: FLORI SLATINA
 www.poradeci.com/mokra

ÇMIMI 20 LEKE

Dimri dhe rrugët për në Mokër

Nga Lutfi MENKSHI

Vendlindja shpesh të kthen andej prej nga je larguar. Në këtë janar me dimër, si shumë emigrantë nga Greqia apo Italia, udhëtoja edhe unë për në Velçan. Dhe si shumëkush na u desh që makinat t'i lëmë në Proptish, apo në Përrenjë. Fajet i kanë rrugët e këqija me gurë e gropa. Megjithatë arrin të udhëtosh falë furgonëve që kanë blerë dhe përdorin vetë banorët. Këto që nga ora 4.30 e deri më 17 pas dite robtohen nëpër rrugët totalisht të shkatërruara. Linja që zbret nga Buzaishta, Losnik, Laktesh, Velçan, Slabinjë e përtej janë të lëna pas dore. Shoferët e pasagjerëve përveç se vuajnë vetë, u shkatërrohen edhe automjetet. Të tillë në Mokrën e Poshtme numërohen 15 copë.

Sipas ligjeve të shtetit çdo shofer paguan detyrimin. Kjo derdhje sigurisht është një e ardhur e mirë që duhet të shkojë për mirëmbajtjen e rrugëve, se ku shkon shuma e derdhur nuk e dimë. Ajo që shohim janë rrugët e këqia. Nga ana tjetër dimë se në Prefekturën e Korçës ka një ndërmarrje mirëmbajtje rrugësh. Mirëpo prej andej askush nuk duket në këto ditë dimri.

Është e thjeshtë të kritikosh komunarët, por në të vërtetë rrugët janë in-



VEPRIMTARI NË KUADRIN E 10 VJETORIT TË SHOQTËS "PELIONI,, DHE TË GAZETËS "MOKRA,,

BOTIMI I SHKRIMEVE.

- 1-Mbi veprimtarinë e shoqatës dhe të gazetës saj. Flori Slatina .Zenun Fero
- 2-Vështrim i shkurtër historik dhe gjeografik mbi vendndodhjen e Pelionit të lashtë .Haki Balliu, Zenun Fero, Zabit Çuku .
- 3-Platforma e gazetës Mokra dhe ecuria e saj në prespektivë. I. Haxhillari, B. Balliu.
- 4-Evidentimi i intelektualëve që kanë kontribuar në sponsorizimin e gazetës 'Mokra gjatë 10 vjetëve si një percjellje mezashi. Z. Fero, S.Leka.
- 5-Publikimi i autorëve kryesore që kanë botuar në gazetën "Mokra" F.Slatina.
- 6-Letërsia në faqet e gazetes në prozë e poezi . Fahri Muço

VEPRIMTARI ORGANIZATIVE

- 1-Takim me stafin e gazetës në kuadrin e vitit të ri 2009, 10 vjetorit gazetës. Dhjetor 2008,- Mars 2009. F.Slatina. P. Zade.
- 2-Krijimi i fondit të botimeve të shoqatës pranë bibliotekës Pogradec. Mars-Prill 2009 I.Haxhillari, LL.Tona, M. Torra.
- 3-Vizitë në monumentet e Selcës dhe filmime e fotografi të ndryshme të trevës. Mars-Maj 2009 P. Zade. D.Mani.A.Rapçe.
- 4-Botimi i një broshure, fletë palosje me të dhëna për për shoqatën dhe gazetën Mokra në vite. Mars -2009.H. Balliu, Z. Cuku, F. Slatina.
- 5-Organizimi i zgjedhjeve te reja për Kryesinë e Shoqatës "Pelioni" dhe mundësia e zgjeimit të saj F.Slatina.H.Balliu.P.Zade.LI.Tona.
- 6-Tematika për të ardhmen e botimeve dhe shkrimeve në gazetën Mokra. F.Slatina.I.Haxhillari P.Zade.LLTona. F.Muço .

MOKRA E DEMOKRACISË

Koha tregoi se vlerat pozitive të popullit nuk ishin thyer, se Mokra, nuk është e "kuqe" e as "blu. Mokra është e mokrarëve trima, patriotë e demokratë

Nga Pëllumb ZADE



Pelioni ra ekonomikisht, jo historikisht

Nga Zenun FERRO

Të shkruash me zemër

Nga Istref HAXHILLARI

Vera, pjesë e pandarë e qytetërimit

Nga Llazi TONA

Gostivari, "qyteti i gostive,,

Nga Zabit ÇUKU

Dimri dhe rrugët për në Mokër

Nga Lutfi MENKSHI

Vendlindja shpesh të kthen andej prej nga je larguar. Në këtë janar me dimër, si shumë emigrantë nga Greqia apo Italia, udhëtoja edhe unë për në Velçan. Dhe si shumëkush na u desh që makinat t'i lëmë në Proptish, apo në Përrenjë. Fajet i kanë rrugët e këqija me gurë e gropa. Megjithatë arrin të udhëtosh falë furgonëve që kanë blerë dhe përdorin vetë banorët. Këto që nga ora 4.30 e deri më 17 pas dite robtohen nëpër rrugët totalisht të shkatërruara. Linja që zbrit nga Buzaishta, Losnik, Laktesh, Velçan, Slabinjë e përtej janë të lëna pas dore. Shoferët e pasagjerëve përveç se vuajnë vetë, u shkatërrohen edhe automjetet. Të tillë në Mokër e Poshtme numërohen 15 copë.

Sipas ligjeve të shtetit çdo shofer paguan detyrimin. Kjo derdhje sigurisht është një e ardhur e mirë që duhet të shkojë për mirëmbajtjen e rrugëve, se ku shkon shuma e derdhur nuk e dimë. Ajo që shohim janë rrugët e këqija. Nga ana tjetër dimër se në Prefekturën e Koçës ka një ndërmarrje mirëmbajtje

rrugësh. Mirëpo prej andej askush nuk duket në këto ditë dimri.

Është e thjeshtë të kritikosh komunarët, por në të vërtetë rrugët janë investim shtetëror. Nëse komuna do të hedhë një makinë zhavorr, do t'ia quajnë shkelje ligjore dhe i duhet ta zhvendosë. Kështu për shembull kur komuna e Velçanit fut ndonjë traktor për zhblokimin nga dëbora, i duhet të prekë fondin e emergjencës. E thënë shkurt del se tradicionalisht Mokra është e lënë në harresë nga shteti.

Një vështirësi e dytë, si në kohën e socializmit, është për udhëtarët, mbasi numri i furgonëve apo autobusëve nuk u përgjigjet nevojat. Ja si shprehet Djana Elezi nga Velçani: "Kam 7 vjet pa ardhur te prindërit. Sot m'u desh 7 orë të pres në Përrenjas, mbasi automjetet ishin shumë të ngarkuar dhe udhëtarëve u duhej të qëndronin në këmbë".

Këto dëshmi i sjellin të gjithë shoferët si Mondit Velos, Fatmir Hyka, Syrja Dervishi, Ameli Sinani, Misir Dervishi, Çelik Torra, Beso Çela etj., të cilët i përsërisin për sakrificat që përballojnë në këtë dimër të keq kur shpesh u duhet të udhëtojnë me zinxhirë.



Si përfundim fshatrat tona, fatmirësisht të populluar, janë populli që vuan jo vetëm për një udhëtim të zakonshëm, por larg qoftë kur ndodh një aksident apo një i sëmure që nuk e transporton dot. Duke shtuar edhe vështirësitë e shitjes të pro-

dhimit, shumëkush shpreh një pakënaqësi për pushtetin qendror dhe të zgjedhurit. Këta të fundit janë mësuar që votat t'i marrin, premtimet të mos i mbajnë. Dhe ja ku zgjedhjet përsëri po afrojnë. Të shohim ç'premtime do të marrim...

VENDIMI I QEVERISË PËR RRIJEN E PAGAVE E PENSIONEVE NË TË GJITHA NIVELET

Nga Eriona ÇOLLAKU

Pagat e gjithë buxhetorëve dhe pensionistave do të rriten në muajin maj 2009. Sipas qeverisë është përcaktuar se rritja mesatare e pagave të punonjësve te sektorit publik është 10 përqind. Pagat e mësuesëve do të rriten me 14 përqind, ndërsa pagat e punonjësve të shëndetësisë do të rriten 12.5 përqind. Me rritjen më 1 maj 2009 nuk do të ketë

pagë të administratës nën 21 mijë lekë, dhe pagë mesatare e administratës do të jetë 46 mijë lekë.

Pensionet e fshatit është parashikuar të rriten 20 përqind, ndërsa pensionet e qytetit do të rriten me 10 përqind. Pra pensioni minimal i qytetit do të jetë 12403 leke, ndërsa pensioni maksimal në qytet do të jetë 21 483 lekë.

Pensionet e invalidëve do të rriten në 11 mijë lekë, ndërsa pensioni i pleqërisë do të jetë 12 mijë lekë.

Pensionet do të bëhen si më poshte:

*Pension minimal në qytet	12403 lekë
*Pension minimal në fshat	7308 lekë
*Pension i pleqërisë në qytet	12200 lekë
*Pension invalidit	11000 lekë

Pagesat në arsim do të bëhen:

*Drejtori i shkollës mesme	41540 lekë
*Zv/drejtori i shkollës mesme	36540 lekë
*Drejtori i shkollës 9 vjeçare	33040 lekë
*Drejtori i shkollës fillore I-IV	31040 lekë
*Edukatore në kopsht fëmijë	20350 lekë
*Mësues i shkolles Mesme	30040 lekë
*Mësues i shkolles 9 vjeçare I-IV	27140 lekë

Pagat në mjekësi do të bëhen ;

* Infermjerët	30600 lekë
* Stomatologët	27853 lekë
* Mjek inspektoriatit sanitar	27853 lekë
* Farmacist	27853 lekë
* Mjek Psikolog	27853 lekë
* Mjek	27853 lekë



Një letër pa adresë për mokrarin tonë, Proletarin



Shkas për këtë shkrim u bë një ngjarje e para ca javëve në Laprakë, kur persona të maskuar sulmuan dyqanin e vëllait të Proletar Balliut, Fredit. Ata jo vetëm që morën paratë dhe sende të tjera, por edhe terrorizuan të vëllanë, duke kërkuar informata për Proletarin. Kjo ngjarje u pasqyrua në shtyp, por unë desha të kujtoj këtu vetëm një fakt kur vite më parë, në prag të shekullit të ri, nga fundi i viteve 90-të, me Proletarin takoheshim shpesh në rrugët e Tiranës. Ai ishte në shërbim, me forcat e rendit, në një kohë të errët, kur pushteti i asaj kohe kishte ardhur në fuqi me anën e njerëzve të armatosur dhe me konflikte të hapura. Në bisedat tona zinte vende edhe shqetësimi i tij se e kishte të vështirë të ushtronte profe-

sionin, drejtësinë, në një vend të tillë ku krimi ishte i lidhur me shtetin. Ai dhe shumë kolegë të tij ndiheshin të rrezikuar dhe për fat të keq, në atë kohë, pati mjaft raste kur policët ranë në krye të detyrës.

Edhe pse kishte kërcënime, Proletari mundi të rezistojë e të punojë disa kohë si polic, por një ditë, mora vesh se e kishte lënë detyrën e tij, kishte ikur nga radhët e policisë. Më vonë e mësova shkakun se kishte pasur disa kërcënime të hapura për të dhe familjen nga persona të inkriminuar. Proletar Balliu hoqi rrobën e policit dhe mori udhët e mërgimit. Ishte e rëndë por duhej, ishte i detyruar. La vendin pa adresë, la shtëpinë e re që mezi e kishte ndërtuar, la dyqanin, gjithçka e bëri në emër të jetës.

Për disa vite nuk pata asnjë lajm prej tij, as adresë.

Vetëm para pak javësh, ë prag të vitit të ri, në media u dëgjua edhe një herë lajmi se dyqanin e tij e kishte bastisur dhe krimi ishte shfaqur përsëri në derë. Ende nuk e kishin harruar...

Proletari, mokrari ynë që si të gjithë ne fillimisht la Mokër, vendlindjen e tij Slabinjën, për një jetesë më të mirë dhe pak vite më parë, la Shqipërinë, për të shpëtuar jetën e familjes së tij.

Kohëra të çuditshme shkojnë e vijnë. Por një gjë është e vërtetë se Proletari, kudo ku është, ai në zemër mban dashurinë për atdheun dhe nuk harron të thotë se jam shqiptar, edhe pse atdheu i tij e kërcënon çdo ditë...

Flori SLATINA

Gazeta "Mokra" në Internet

Që nga numri 111 gazeta "Mokra" ka dalë në internet, ne adresën e mëposhtme:

www.pordec.com/mokra

Tashmë edhe mokraret që nuk banojnë në Shqipëri do të kenë rastin të shikojnë në internet gazetën e përmuajshme "Mokra".

VEPRAT ENERGJITIKE QË DO TË NDËRTOHEN NË MOKËR

Nga Zabit CUKU

Këshilli i Ministrave ka miratuar në janar 2009 vendimin për ndërtimin me koncension të 35 hidrocentraleve dhe po negociohet për ndërtimin e disa të tjerëve. Për ndërtimin e 43 veprave energjiktike do të investohen 162 miliardë lek.

Kontrata për ndërtimin e këtyre hidrocentralve është lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjiktikës me shoqëri të interesuara. Kontrata për ndërtimin me koncension të këtyre hidrocentraleve është bërë në formën BOT (Ndërtim, Operim dhe Transferim) Ndërtimi i 35 hidrocentraleve do të mundësojë prodhimin e 839 milionë kilovat energji. Kostoja e shpronësimit të vendosjes së digave do

të paguhet nga ana e qeverisë shqiptare.

Në Mokër janë miratuar për ndërtimin e veprave energjiktike si më poshtë;

HIDROCENTRALI "SLABINJË"

* Subjekti LNK Shpk.
* Investim 1290117487 lekë
* Fuqi 9300 KW
* Energjia 50 000 000

HIDROCENTRALI "BISHNICA 1" "BISHNICA 2"

* Subjekti BSH Titan Shpk, Osmani Shpk.
* Investim 250 000 000 lekë
* Fuqi 2.950 KW
* Energjia 12 910 000

HIDROCENTRALI "STRAVAJ"

* Subjekti Mak Olimpik Shpk.
* Investim 503 529 364 lekë

* Fuqi 3626 KW
* Energjia 16 317 000

HIDROCENTRALI "NIÇË"

* Subjekti Devy Shpk, Zyfi Shpk.
* Investim 49 800 000 lekë
* Fuqi 600 KW
* Energjia 2740 000

Projektet e reja të rrugëve që do të nisin gjatë vitit 2009 në Pogradec

* Ndërtimi rrugës Qukës - Qafë-Ploçë, loti 1.

* Sistemim asfaltim rrugës Pogradec - Turshemisht - Doganë.

* Sistemim asfaltim rrugë Qafë-Thane-Lin-Pogradec loti 1, loti 2.

* Sistemim asfaltim rrugë Librazhd - Fushë-Stude loti 3.



Nga Pëllumb ZADE

Ka qenë 1 shkurti i vitit 1992 kur në komunën e Trebinjës, mbajmë një miting për rrëzimin përfundimtar të pushtetit të vjetër, e për të organizuar zgjedhjet e lira parlamentare të vitit 1992, ku merrte pjesë edhe "Heroi i Demokracisë" Azem Hajdari. Midis të rinjve që e shoqëronin ishte edhe dëshmori i demokracisë Shpëtim Elmasllari nga fshati Mëmëlisht, por që nuk mund të brohoriste si gjithë të pranishmit në këtë miting të ftohtë nga dëbora e dimrit, por shumë të nxehtë nga zemrat e njerëzve të mbledhur nga shumë fshatra të Mokrës. Ai jep jetën gjatë rrugës nga Proptishti për në Trebinjë, i asfiksuar në një makinë të mbyllur, një ngjarje kjo që na trishtoi shumë të gjithë pjesëmarrësve në këtë aktivitet. Të rrezikuarit e tjerë në po atë makinë, Fatmir Bregu nga fshati Trebinjë e dy të tjerë mundën të shpëtojnë falë ndërhyrjes të menjëhershme e energjike të punonjësve të spitalit Trebinjë. Shpëtimin e varrosëm në fshatin e tij të lindjes me të gjitha nderimet, si e meritonte, por jeta e tij u ndërpre në mes në një moshë shumë të re, nga dëshira për të sjellë demokracinë në Mokër sa më shpejt, e për këta heronj, pena nuk duhet të lodhet kurrë.

Kishte ardhur koha për ndryshim.

Sistemi komunist i mbajtur me diktaturë për gjysmë shekulli, nuk kishte më mundësi jetese, jo vetëm nga faktori i brendshëm, politik e ekonomik, por edhe nga zhvillimet e jashtme. Ishin vitet 90, kur pothuajse të gjitha shtetet e lindjes ish komuniste; me rënien e murit të Berlinit, e kishin bërë zgjedhjen e tyre, duke u ndarë përfundimisht nga ai sistem, tashmë i dështuar plotësisht.

E pa dyshim, edhe vendi ynë nuk mund t'i shmangej këtij realiteti, ndonëse disi me vonë.

Zona e Mokrës prej kohe ka qenë shembull më i shkëlqyer i cilësive pozitive që karakterizonte popullin e saj, si patriotizëm ndershmëria, sinqeriteti, bashkëjetesa fetare, etj. cilësi këto të trashëguara brez pas brezi që nga lashtësia. Edhe se një zonë me terren të thyer malor, populli i saj punëtor ka ditur të zhvillojë një ekonomi modeste edhe në kushtet e një prapambetje të thellë teknologjike të kushtëzuar nga pushtuesit e huaj, por që asnjëherë nuk kanë mundur ta nënshtrijnë ideologjikisht këtë popull.

Fiset më të mëdha të zonës si Çollakët, Bacët, Çelat, Blloshmet, Muçot, Zadet, Kaprët, Spahot, Macollët, Isufajt e shumë të tjerë kanë qëndruar në vijën e parë të frontit për ta mbrojtur Mokrën nga të huajt, por epërsia e madhe ushtarake e tyre, ka bërë që jo rrallë herë, edhe të bëhen

pushtues të saj, duke e plaçkitur e masakruar, barbarisht.

Me fillimin e Luftës së Dytë Botërore Mokra nuk e humbi traditën, duke ju përgjigjur zjarr për zjarr pushtuesve italianë e më pas atyre gjermanë. Në këtë shkrim, nuk dua të merrem me historinë e luftës, atë le ta bëjnë e duhet ta ribëjnë historianët, por desha të theksoj se vendosja e sistemit komunist pas lufte, qe një zgjedhje tepër e rëndë për popullin.

Gjatë viteve të luftës, të shumtë qenë dëshmorët që luftuan për çlirimin e Mokrës. Ata sakrifkuan gjakun e tyre për atdheun, për të ngritur një shoqëri të lumtur, e për këtë, kanë qenë e do të jenë shumë të nderuar për jetë, por që sistemi komunist e përdori gjakun e tyre për interes të ngushta politike. Duke sulmuar e eliminuar në mënyrë sistematike famil-

jen apo intelektualët më të njohur të zonës, duke shpallur kulakë (një term i huzuar nga Rusia e Stalinit) të gjithë ata që nuk e donin sistemin komunist, duke prishur kisha e xhamia, duke hapur burgje e internime politike, komunizmi synonte që të fuste përçarjen e urrejtjen ndërmjet fiseve kryesore të quajtura agallarë e bejlerë, me pjesën tjetër të popullit.

Edhe se u fabrikuan epitete si "Mokra e kuqe" apo "Mokra e Enver", edhe se u stisën personazhe të tipit të realizmit socialist, duke e shtrëmbëruar tërësisht realitetin historik të kohës, populli i Mokrës vërtetoi se e ruante ende të pa prekur dinjitetin e tij. Kjo u vërtetua në vitet 90, kur pa rezerva, pa ndarje klasore, fetare apo bindje politike, u bashkua për ta shporrur sistemin komunist 50 vjeçar e për të rivendosur një sistem demokratik

Mokra e demokracisë

Koha tregoi se vlerat pozitive të popullit nuk ishin thyer, se Mokra, nuk është e "kuqe" e as "blu. Mokra është e mokrarëve trima, patriotë e demokratë



Pamje nga mitingu i shkurtit në Trebinjë. Autori duke mbajtur fjalimin

shumë partiak, me një liri të plotë të fjalës, lëvizjes, ekonomisë etj. të shumtë qenë ata që kontribuan në këtë proces. Pogradeci, e sidomos Mokra, qenë ndër të parët që përkrahën pa rezerva këtë lëvizje popullore. Që në ditët e para të janarit 91, u krijua PD e që brenda pak ditësh ajo përfaqësohej në të gjithë fshatrat e zonës, duke lënë mbrapa shumë rrethe të mëdha të vendit.

Koha tregoi se vlerat pozitive të popullit nuk ishin thyer, se Mokra, nuk është e "kuqe" e as "blu. Mokra është e mokrarëve trima, patriotë e demokratë.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 1992, u votua në mënyrë masive për kandidatin e Partisë Demokratike z. Jemin Gjana. Por duhet theksuar se edhe në dy zgjedhjet e fundit parlamentare, edhe se në vështirësi të shumta ekonomike, Mokra ka votuar dy kandidatët e saj duke treguar se ajo nuk e ka hequr besimin se qeveria e PD do zgjidhë hallet e saj.

Por shtrohet pyetja: Për çfarë vuan sot Mokra? Natyrisht, nevojat janë të shumta, mbasi shumë pak është bërë për të nga qeveritë paraardhëse, por mendoj se një është çelësi i zgjidhjes së problemit e kjo është infrastruktura rrugore. Është e vërtetë se një pjesë e madhe e popullatës është larguar nga zona duke kërkuar një vend jetese më të mirë në zonat urbane por megjithatë një pjesë e konsiderueshme, vazhdon të banojë e jetojë atje. populli i Mokrës nuk kërkon ndihma e lëmosha, ai është mësuar që me gjithë terrenin e lartë malor, me shumë shi e borë, si nikoqir i mirë të racionojë ushqimin e siguruar për muajt e dimrit. Problemi i Mokrës është rruga automobilistike. Megjithëse shtrihen në një terren mjaft të gjerë, e vetmja rrugë që e përshkon atë zonë është ndërtuar 70 vjet më parë, për interesat e luftës e më pas jo vetëm që nuk është investuar, por edhe nuk është mirëmbajtur si duhet, e sot në kushtet e tregut të lirë kur shumë zona të vendit kanë rrugë moderne, kjo zonë ka mbetur krejt e izoluar.

Zgjidhja përfundimtare e këtij problemi do ishte lidhja e rrugës kryesore Korçë-Qafë Ploçë me Tiranë - Qafë Thanë, duke kaluar përmes Mokrës, duke filluar nga Ploça-Guri Kamjes, Trebinjë, Propolisht e Qukës, një segment që është vlerësuar së tepërmi edhe nga vetë Kryeministri Berisha. Kjo rrugë do i japi një zhvillim të madh të 5 komunave që shtrihen përgjatë saj, një zonë me shumë prodhime bujqësore, blegtorale e sidomos fruta-perime të pastra por që u mungon përpunimi e tregu. Kjo rrugë le të jetë edhe shpërblym që Partia Demokratike e Qeveria e saj i bëjnë popullit bujar, punëtor e demokrat të Mokrës.

Le të japim të gjithë kontributin tonë për realizimin e këtij projekti.

Rreth librit të autorit Haki Balliu "Rënia e Pelionit"

Nga Zenun FERO

Autori Haki Balliu më 19 dhjetor 2008 nxori librin e tij "Rënia e Pelionit" novela e tregime, me redaktor Fahri Muço, radhitja kompjuterike Zabit Çuku, arti grafik Flori Slatina, botim i Shoqatës "Pelioni".

Nga shoqata "Pelioni", po pritej se autori kishte kohë që punonte. Çdo herë e pyesim se në çfazë ishte, ai u rrit gradualisht, por dita që e morëm në duar, na ka lënë mbresa të mëdha. Shumë nga antarët e shoqatës "Pelioni", si Sami Leka, Zabit Çuku, Pëllumb Zade, Mine Fero e tjerë shprehin urimet më të mira për autorin e librit "Rënia e Pelionit".

Libri "Rënia e Pelionit" është me temë historike, ku ngjarjet zhvillohen në Qytetin Ilir pranë Selcës së Poshtme, Pelion, në krahinën e Mokrës. Këtë emër, këto ngjarje shumë autorë të ndryshëm, kanë dashur t'i spostojnë. Por nuk mbulohet dielli me shoshë, thotë populli. Arkeologu Neritan Ceka me librin "Qyteti Ilir pranë Selcës së Poshtme, Tiranë, 1985 thekson "Monumente të tilla nuk njihen ende në Greqi, Maqedoni, dhe është e qartë se janë rezultat i një frymëzimi autokton", faqe 6.

Shumë autorë, arkeologë, shkencëtarë kanë shkruar për Pelionin, por edhe autori Haki Balliu me punën e kushtoi dy libra. Libri i parë "Brikena e Pelionit", novella e tregime, Tiranë 2004, krijoi tek lexuesit njohuri të thella për Pelionin, dhe ato u shprehën në shumë shkrime të botuara. Pas katër vjet pune, autori Haki Balliu arriti të botojë librin e dytë "Rënia e Pelionit" tregime e novela. Është një punë për t'u falenderuar, dhe i ka bërë nder Mokrës, me këto libra.

Në vendbanimin e lashtë të Selcës Poshtme jetë ka patur që në periudhën e Neolitit të vonë rreth 2700-2100 para krishtit, në periudhën e Bronzit të hershëm rreth 2100-1800 para krishtit, periudhën e Bronzit të vonë rreth 1400-1200 para krishtit, në periudhën e hekurit të hershëm 1200-600 para krishtit, në periudhën proqytetare 600-350 para krishtit, në periudhën qytetare 350-100 para krishtit, në periudhën qytetare deri 100 pas krishtit, dhe në periudhën e antike të vonë nga 320-570 pas krishtit.

Nga gjysma e shekullit 4-të para krishtit ai kthehet në një qytet, dhe fillimi i ndërtimeve monumentale nga fundi i shekullit 4-të para krishtit, pasqyron pa dyshim kohën e lulëzimit të tij. Është një qytet i lidhur me territorin bujqësor-blektoral të Mokrës dhe po aq me kontrollin e rrugës së heshme në luginën e Shkumbinit.

Fushata që ndërmori Aleksandri i Madh gjatë vitit 335 para krishtit për të aneksuar Pelionin ndeshi në kryengritjen e Klitit, i cili bashkë me Glaukun, i qëndroi. Ishte përshkrimi i gjallë Arianit dhe Rufit që Pelionit i jepen meritat që i takonin. Ariani krijoi idenë e Pelionit si "qyteti më i fortë në këtë vend",

Ilirët që i kishin dalë Aleksandrit përpara qytetit "Zunë vende të përshatëshme, pyje e rrugë",

Luginës së Shkumbinit, Pelion lëvizimin ushtrisë romake. Pelion u kthye në një mbështetje tëq ushtrisë romake, ishte një pikë e rëndësishme, por jo në vijën e parë të luftës, por në prapavijë ku kalonin furnizimet. Pelionit i burimeve historike ishte një rezistencë mbretërore e Klitit dhe ndoshta e paraardhësit të tij, Bardhyllit Plak dhe e pasardhësit, Bardhyllit të Ri.

Për shkak të kushteve të reja politike dhe ekonomike që u krijuan, njohu më pas edhe fazën e rënies. Në fund të shekullit I-rë pas Krishtit u bënë zhvendosja e transesë kryesorë të rrugës

PELIONI RA EKONOMIKISHT, JO HISTORIKISHT



Egnatia drejt Qafë-Thanës dhe Lyhndit, e cila solli rëninën ekonomike të Pelionit. Ai ka zënë një pozitë kyçe, ka pasur një jetë mjaft të gjatë, lidhje ekonomike dhe politike me një numur banimesh të afërta.

Në periudhën qytetare 350-200 para krishtit, bëhet shtimi i vendbanimeve, behet qendër ekonomike dhe politike e krahinës Mokrës. Vendbanime lindën në Rodokal, Homesh, Homçan, Slabinjë

etjerë.

Në periudhën e antikitetit të vonë, vitin 320-570 pas krishtit ka një radhë fortikimesh të tjera, në Manastirec krijohet i ri, në Slabinjë, Zemçë, Shpellë, Qafë-Thanë, vendi i krijuar në Sofrën e Skëndërbeut, Pishkash e tjerë, Vendbanime të hapura ka pasur në Trebinjë, Vërri, Pleshisht, Golik, Urakë, Përrenjas e tjerë.

Dyndjet barbare kanë qenë një fak-

tor nxitës për krimin e këtij sistemi fortifikimi. Ato arritën në thellësi dhe e shkatërruan, veçanërisht gjatë sundimit të Valentinianit I-rë (364-375), Teodosit (379-395) e më pas. Në çerekun e fundit të shekullit IV, dyndjet gote sollën shkatërrimin e krahinave ilire, dhe Selca pati të njëjtën fat. Por në shekullin IV-VI pati ndryshime të theksuara, një periudhë e qetë, kur vihet re një rigjallërim i vendbanimeve të kapura, fshatarë dhe i jetës kulturore.

Në vitin 395, kriza ishte e thellë në perandorinë binzantine me të u përfshi edhe ekonomia, U krijuan qytete me infrastrukturën e plotë. Në periudhën 487-488, në kohën e Anastasit ka një intensifikim të jetës në këtë qytezë, ndërsa në periudhën e Justinianit (527-528), Pelionit nje ngritjen më të lartë.

Dyndjet sllave te vitit (547-548), bënë shkatërrime të tmerrshme në gjithë Ilirinë, duke vrarë e kthyer në skllëvër të gjithë ata që dilnin përpara.

Këto fakte historike nga autori Haki Balliu janë trajtuar në mënyrën artistike në librin "Rënia e Pelionit" Ai është quajtur "Zemra e Qëndresës", me kryekomandant Belirianin. Zhdukja e Pelionit bënte pjesë në planet e disa shteteve barbare, këtë nuk e braktisin Beliriani, ai bashkëpunonte me komandantët e tjerë të zonës Dimço Dragoti (Trebinja) Tauri (Slabinjës) Yllko (Mnastireci) Kubri Lekën Proptisht), që përbënin Këshillin e Luftës.

Pushtuesit ishin pesëfish dhe u mundën në Pelion. Përgatitjet ishin për të përballuar forca të shumta. Në çdo fshat e vendbanim burrat flinin me shtatën zhveshur, gratë me hark tek koka e nënat me dorën tek djepi (faqe 35). Çdo komandant kalaje sillte përforsim për mbrojtjen e Pelionit. Kalorsit rrinin në gatishmëri, merrnin lajme për kundërshtarin.

Masat e marra, Pelionit kaloi dimrin e vitit 548, por kalaja e Manastirecit (Ylkos) ishte sulmuar disa herë. U propozua ideja e bashkimit të tre kalave, për mbrojtjen e Pelionit 1000 vjeçar. Dhe armiku u tërhoq nga sulmet që u bënë.

Pelionit u mbajt, por forcat armike ishin të shumta. Ai ra, mbasi mori heroikisht pjesën e vet të historisë.

Rruga Egnatia, Pelionit asnjeherë nuk kanë humbur vlerat e historike në shekuj. Kanë marrë vlerat Historike që u takojnë. Në shekullin e 20-të në vitin 1939, në trasenë e rrugës Egnatia hapet rruga automobilistike, që i dha jetë krahinës Mokrës. Pelionit nga shkencëtarët shqiptarë mori vendin që i takon. Në shekullin e 21-të, në vitin 2009 në trasenë re rrugës Egnatia, propozohet te hapet autostrada Qukës-Ploçë. Kjo ka shumë anë pozitive, i jep jetë krahinës së Mokrës, distance e rrugës shkurtohet me 27 kilometra, kushtet klimatike janë më të favorshme, nuk bllokohet nga dëborat e akulli, sepse ndjek drejtimin e luginës.

Autori Haki Balliu e mbyll tregimin me fjalët e Dasarës, një nga personazhet e tij "Pelionit le të mbetet Troja jonë. Ne do të qëndrojmë në këto visore, se këtu kemi qenë qysh kur në anët tona, diellit i pa syri njeri".

IKËN FËMIJË NGA MOKRA, KTHEHEN ME FËMIJË

Nga Zabit ÇUKU

Boritë e makinave bien dhe gratë lene çdo punë e dalin të marrin vesh kush ka ardhur.

Ndonjëra pret të heqi gjellën nga zjari e del e i thërret gjithones;

E, moj, kush erdhi nga djemtë? Ata të mitë nuk kanë ardhur akoma. Kurse burrat duan të mos e japin veten, tregohen më kokë pa çarë, janë burra zakoni, kërkojnë të fshehin mallëngjimin "E hu

le të vijmë kur të duan, vetëm mirë të jenë "Por përsëri vetja i tradhëton. Ndez in një cigare dhe me shtëllungat e tymit që nxjerrin, ngushëllohen. Makinat njëra pas tjetrës vijmë në Mokër. Nënat dalin takojnë djemtë duke i ndihmuar të marrin çantat që kanë sjellë me vete. Ata fshatarë që dukeshin të heshtur ditët e festive sikur këto ditë gjetën vetë veten. Gjithë nënave dhe baballarëve u qeshte buza, u ishin ngritur supet sepse u kishte

hyrë gëzimi në shtëpi. Ato shtëpi të bukurra dhe të mira para disa kohësh ishin të shurdhëta, por këto ditë fund dhjetoi dhe fillim janari kishin ndërruar komplet pamjen dhe kudo shikon levizje dhe për të kryer një rregullim dhe zbulurim të shtëpisë. Gëzimin nuk e fsheh dot. Ai duket kudo në çdo cep të fshatit, të shtëpisë apo të oborrit, ca më tepër duket në guzhinat ku po beheshin përgatitjet e pritjes së festive dhe të atyre që do të



“ I bekuar është ai që mund të ndalojë në gjysmë të rrugës para moshës së tretë, ka iluzione dhe i rezervon ato me dashuri “.
Luixhi PIRANDELO

Të shkruash me zemër

(Meditim mbi librin “ Rënia e Pelionit “ të Haki Balliut)

Nga Istref HAXHILLARI

Në realitetin e trishtë, kur përbindëshi elektronik gllabëron energjinë e njerëzve, kohën, shkrimësinë dhe njerëzit e letrave konsiderohen anakronikë, Haki Balliu shpërfill kohën dhe na sjell një libër me vlera të dyfishta, historike dhe letrare. Shpirti i tij nuk mund të robërohet nga teknologjia se ruan brenda vetes rezerva misterioze të një malli që nuk vdes kurrë, të paasimilueshëm nga koha dhe harrimi, një lloj si elementet fisnike të kimisë, ari apo platinë. Kujtesa e tij plagosur vite të shkuara nga gjeneral Teodori i mençur nuk gjen shërim, klith dhe shurdhon shekujt e ikur.

Rënia e Pelionit, e gjëmshme me përmasa apokaliptike si rënia e Kostandinopojës, humbëtira e Trojës, renia e Durrësit në duart e osmanëve më 1501, apo groposja e Pompeit. Koha e zhurmëshme e Pelionit qe braktisur si murgeshë e verbër, krejt e vetme në një humbëtitirë ankthi. Trupat e shekujve

(jo pak por katërmbëdhjetë), ndryshuan duke pasuar njëri - tjetrin por epiderma e tyre mbeti e njëjtë si filli i Arianës mitologjike, prej ku autori ze të çmbështjellë lëshin e enigmës së vjetër. Heronjtë e lashtësisë mokrare kanë populluar imagjinatën e ndezur të Haki Balliut, që i përkëdhel prej vitesh me dashurinë e atit të dhembshur bijtë e tij.

Me shpirt shenjtor dhe mendje dijetari kthehet mbrapsht në kohën e thinjur, e detyron të rrjedhë në kah të kundërt, rëmon mundimshëm me mjete të holla dhe na sjell zhurmën e Pelionit të madh, qytetërimin e lashtë mokrare. Ashtu kanë bërë të tjerë burra të mençur përpara tij. A nuk u kthye mbrapsht në kohë zbuluesi i Trojës, Shlimani për të na risjellë nga lashtësia qytetin e vjetër, enigmën botërore përmbi dymijëvjeçare?

Në faqet e librit lëvizin Dasaretët e famshëm, banorët e pashëm të trojeve tona. Burrat trima dhe gratë e hijshme, të guximshme bëhen fli në betejën më të ashpër në histori. Autori zgjon nga gjumi përmbi një mijëkatërqindvjeçar mbretin plak Elin, prijësin legjendar të fisit të madh ilir, të menduar e trishtuar për fatin e lig të shpirtit të tij bërë një me Pelionin e kërcënuar nga hordhitë e panumërta sllave, dyndur si lukuni egërsirash prej veriut të Europës. Dasara e hijëshme me gjak mbretëror e do jetën dhe njerëzit, dashuron me tërë forcën e shpirtit femëror, lufton me zemrën e gruas dhe mendjen e princeshës. Në këshillin e luftës, thirrur me ngut, hyn Beliriani, kryeprijës i Pelionit dhe pas tij të tjerë princë, Dimço Dragoti me pamje dijetari, Tauri, Yllko etj ardhur nga Gjemthi, Kozici, Jama, Kamja e Pishkashi. Pa vjen me rrapëllimë të zhurmëshme ai Kubri Leka i mençur e i pamposhtur, që nuk i dhimbset as jeta as



kamja.

Zenë e gjallojnë njerëz të shumtë, burra e gra, që kanë fjetur shekuj të tërë aty nën Gradishtë dhe përtej saj në hapësirat e gjëra të dheut mokrare. Nën penën e Haki Balliut peisazhi i groposur, shformuar dhe paralizuar për katërmbëdhjetë shekuj fillon të lëvizë si dikur. Marrin jetë vende të begata, njerëz dhe ngjarje të bujëshme në ato mote të lavdishme. Eordei, lumi i shenjtë i vendit, arteria e Dasaretëve lëviz madhështor nëpër gjurmët e atij burrit të stërvjetër që e ndillte për t'i shpënë ujë detit në këmbim të kripës për njerëzit e vendit të tij. Me fantazi të plejshme krijuesi, po edhe guxim hulumtuesi që ka gërmuar prej një kohe të gjatë na sjell qartë në sytë e mendjes oshëtimën e kohëve të lavdishme. Dasaretët nuk ishin mposhtur një mijëvjetet radhazi dhe patën bërë me turp edhe Aleksandrin e Madh të Maqedonisë moteve të përlargëta.

Ngjarjet dramatike të stuhishme të shekullit VI ogurzi përzier me dredhitë e fshehta të bizantinëve, që e zhbënë Pelionin e madh dhe dogjën qytetërimin një mijëvjeçar shpalosen me logjikë të habitshme. Në fund të novelës Dasara e mposht në dyluftim burrëror gjeneralin sllav. E mund mjeshtërisht me lakun e litarit thurur nga leshti i bagëtive të vendit të saj.

Po horizontet e Pelionit po mbylleshin të ngurtësuar si sarkofagë. Të huajt e uritur nuk ndaleshin përpara rezistencës heroike të vendasve. Jeta vlerësohej më pak se gjithshka nga hijenat e veriut të kontinentit të vjetër. Pelioni duhej të binte. Në se mbetej qyteti i madh, qendra më e rëndësishme e Dasaretëve dhe krejt Arbërisë, sllavët duhet të ktheheshin mbrapsht në hapësirat e ngrira rreth polit të veriut, ndaj nuk jepeshin përpara asnjë pengese. Gjaku u derdh rrëke dhe në hapësirën



dasarete të asaj kohe u përshfaqën lulekuqet e çuditshme të Mokrës, që nuk u thanë kurrë as sot e kasaj dite. Si rrallëkund, pllajat dhe kodrat e buta të Mokrës mbulohen vit pas viti, aty më të dalë të pranverës me lulet e kuqe flakë, që veshin tokën si qilim i purpurt. Ndoshta gjaku e derdhur nëpër kohë toka e nginjur nuk e mban dot brenda vetes, ndaj e shpërfaq në syprinën e rrudhur e valëzuar të truallit lashtësor mokrare.

Ngjarjet përplasen me njëra - tjetrën furishëm, derisa shtrëngatat e moteve dhe emrat gurëzohen përfundimisht në një heshtje memeece. Kush është fitues e kush i humbur? Ja fjalët e fundit të Dasarës:

- Pelioni le të mbetet Troja jonë. Ne do të qendrojmë në këto visore, se këtu kemi qenë qyshkur Diellit i pa syri njeri.

Enigma e betejës ndriçon shekujt dhe udhëton nëpër kohë, përndez shpirtin e njerëzve prej nga zenë fill legjendat e mahnitshme të vendit. Gjatë leximit më dukej sikur kisha përpara një vepër të sër Uollter Skottit që ngrinte nga përgjumja kalorësit e mesjetës angleze apo Xhovanjolin që udhëton përkrah Spartakut në Romën antike.

Qyteti legjendë u gropos me baltën e vendit të tij, u fsheh nën tokë, mbuluar me rrapëllimë gurësh e dherash ku ndenji tulatur për një kohë tmerrësisht të gjatë. Ndoshta fshehtësira e mbrojtja Pelionin nga grabitësit për një mijëkatërqind vjet. Të huajt grabitën sa mundën thesaret shqiptare në kohët e vjetra dhe ato më të reja; romakët Butrintin, francezët Voskopojën, austriakët Lezhën. Pelioni kishte shtijëzuar për katërmbëdhjetë shekuj mostrën e harrimit, kafshën tinzare që kishte dashur të ushqehet me mishin e kufomës së tij. Duhej përkushtimi i profesorit tonë të letrave mokrare të fshinte

pluhurin e frikshëm, të shpërbente harrësën dhe të nxirte në dritë krenarinë e dheut, rrënjët e arta të vendit tonë të begatë. Pas kaq vitesh të gjata nga renia e tij, përmes librit më të ri të Hakiut përjetojmë të gjithë atë gjendje të veçantë, kur Pelioni hijerëndë dhe sundues, siç janë shpesh munguesit, shkaktton trazim, prishje drejtpeshimi, po më së shumti krenari si bij të këtij vendi me kaq shumë bëma dhe histori. Ngjarjet e novelës “ Rënia e Pelionit “ janë rrëfime të skalitura, halucinante, diçka midis ngjarjeve dhe përrallës të thurur me dorë mjeshtri.

Autori nuk ndalet këtu. Vijnë më pas novelat “ Dhjetë grosh dhe një grusht kripë”,

“ Personazhe që vijnë vetë “, tregimet brilante “ Brenga e Dashanit “ dhe “ Dollia tragjike “, publicistika dhe kritikant letrare. Po të përjashtojmë dy zhanret e fundit duket se Haki Balliu synon të japë një tablo të jetës mokrare përgjatë një shtrirjeje kohore tepër të gjatë duke zënë fill nga antikiteti, mesjeta e herëshme dhe kohët moderne. Një sagë mokrare. Ai vizaton tablo të holla të karakterit, përcjelljet e mençura të ngjarjeve dhe situatave tragjike nga banorët e trevës sonë në kohët e ndryshme, vendet e hijëshme ku nuk mungon asgjë dhe veçan shpirtin e njerëzve të thjeshtë.

Novela “ Dhjetë grosh dhe një grusht kripë “ evokon vetitë e mrekullueshme të shqiptarëve në shërbim të fuqive të huaja, ku ata shkëlqejnë teksa vendi i tyre lëngon nga zgjedha shekullore. Temës së mërgimit i kthehet në tregimin “ Dollia tragjike “, një trejtesë letrare tepër e dhimbshme dhe e hollë në letrat e sotme shqipe. Tek novela “ Personazhe që vijnë vetë “ Haki Balliu, si rrallë tjetër pa asnjë mendësi e paragjykim, po me vërtetësi rrënoqethëse vizaton tabllonë e zymtë të diktaturës gjysmëshkullin e shkuar dhe pasojat e saj rrënuese. Brenda Samelës së brishtë, fshihet një botë e madhe, ëndrra e përjetëshme e lirisë, aspiratë e dhimbshme e shqiptarëve për një kohë të gjatë. Zaken e gdhend mjeshtërisht si një skulptor i talentuar sa të duket se brenda volumit njerëzor, fshihen volume shpirti shumë herë më të mëdha.

Rjeshtat e librit rrjedhin vetë pa ndonjë farë sforcimi se janë fjalë që burojnë nga shpirti i trazuar, ndaj leximi është kënaqësi estetike, drithërimë shpirti dhe krenari.

Ky është Hakiu, i mençur, i mirë në thelbin e vet njerëzor, penë e hollë drithëruese, rrëfimitar i lindur, shkollë e letrave të sotme mokrare e më gjerë.

Në kufijë e një shkrimi gazete e kam vështirë të përmbledh impresionet e shumta të novelave dhe tregimeve të librit, po kur e mbarova së lexuari në orën shtatë të mëngjesit në një ditë të ftohtë dimri të këtij viti në Pogradec, nuk mund të rrija pa i dërguar mikut tim të dhembshur mesazhin:

“ Ke shkruar më shumë me zemër se me penë “.

Në Pogradec më 30 janar 2009

← vinin për festat e fund vitit .

Kishin ardhur fëmijët, prindërit të afërmit nga kurbeti. Nga gëzimi që ky ishte një mallëngjim i ligjshëm u shkëputeshin e dhe pika loti. Nuk ka se si të mos u shkëputeshin. Se disa kanë ikur fëmijë dhe tani jënë kthyer baballarë me fëmijë .

Dikush i kap për dore dhe dikush i mban në duar . Sa krenarë se baballarët dhe kushdo me djersë, sakrificë po dhe me gjak kanë vënë ekonominë e tyre. Një takim i përmallur. Iku djallë apo vazjë beqar dhe tani kthehet me djallë ose vazjë. Ishin rritur në emigrim, por gjuhën shqipe

e flasin dhe e shkruajnë sikur të kishin qënë në shkollë. Një edukim atdhetar aq dhe familjar. U ndamë përsë gjalli, por është mirë të vijnë se neve na merr malli për gurët, për le për njerëzit. Kudo në çdo fshat të Mokrës dhe gjithë zonës ka një gjallëri në këto ditë feste. Bisedat midis njëri tjetrit marrin rrjedhë, dhe secili shpreh mendimet, mbresat, flasin për shëndetin, punën dhe për shoqërinë kishin .

Sa me mallëngjim dhe keqardhje flasin dejmte dhe vajzat për vendlindjen, për atë dheun e tyre të dashur .

Kush na ka mallkuar që ky vend kaq i

begatë e me këto pasuri natyrore të para të vuaj kaq shumë ? . Pse ky trazicion kaq i gjatë në vendin tonë ?

Secili shpreh mendimet e tij se si mund të bëhet më i begatë, vendi, fshati infrastruktura ku jeton ai në vendlindjen e tij.

Këta nuk janë politikane pro kane futur një kulturë pune dhe jetese nga jashtë , këtë ata e shprehin me me plot gojën që djersa dhe munda tyre të derdhet në vendin e tyre të lindjes, duke e zbukuruar atë dhe jo bota .

Takohen djemtë e Mokrës me njëri

tjetrin dhe çmallen. Takohen fëmijët e tyre dhe njihen. Sa takime mallëngjyese dhe të bukura ashtu si janë vetë njerëzit tanë .Po takohen brezat . Po po, mund të quajmë një takim spontan takim brezash. Nën atë dhë baballarët, te afërmit midis urimeve dhe lotëve, i dëgjojnë me kujdes , por u japin e dhe porositë : Ah se mos na harroni, na kujtoni dhe ejani sa më shpesh!.Po secili do të largohet në punën e tij dhe kështu fshati apo lagjja do të mbetet dhe kthehet përsëri në gjendjen e mëparëshme. Hajde urime, rrugë të mbarë dhe mirëse të vini

Me verë, kur t'ap shpirt kungomëni,
Me verë lamëni, bekomëni,
Me fletë pjergull pështellmani
Në kopsht me këngë e rrush mbështillmi
Dhe kur të shuhem nën dhe të zi,
Dhe kur të bëhem prapë balt e hi,
Mbrumëmi poçe, mbushëmi dolli,
Dhe shihni po s'u ngjalla përsëri

Omer Kajami

Pogradeci ka qenë i banuar që nga periudha e Neolitit (6000-2000) para Krishitit. Banorët e hershëm të kësaj treve janë mitologjikë. Ata janë ilirë të lashtë të quajtur enkelenë (fisi ngala). Fakt për këtë janë varret monumentale të Selcës së Poshtme, që tregojnë për një zhvillim të madh të jetës në këtë zonë. Sipas burimeve antike kjo trevë është banuar nga ilirë. Liqeni tektonik më i thellë i Ballkanit (230 m) dhe një nga më i rëndësishëm në Evropë. Prania e një numri të madh llojesh endemikë parruazorë (Moluske Gastro-pode) dhe rruazorë (peshq) i japin Liqenit vlera të trashëgimisë botërore. Ky liqen është mjaft i rëndësishëm për nga shumëllojshmëria e shpendëve dimëronjëse të ujit në vendin tonë. Është një zonë e rëndësishme turistike dhe pushimi.

Në trevat e Pogradecit ka mjaft festa popullore të cilat kanë mbetur sipas traditave të zonës dhe ngjarjeve fetare: Dita e Ujit të Bekuar që festohet më 6 Janar kur hidhet kryqi në liqen, xinxifilla që është festë ndërkomëtare e kukllave; Dita e Fituesëve me 31 Janar; Dita e Liqenit të Ohrit me 21 qershor; Festa e Shën Marenës së Llogës më 29-30 korrik; Festa e Vjesh-tës poetike në tetor; Festivali i verërave në dhjetor.

Pogradeci një ndër perlat e kulturës shqiptare, njihet si qytet i luleve dhe si zonë e rëndësishme që në Iliri. Enkelenët dhe deseretët, pogradecarët e sotëm kanë pasur një koleksion kultesh. Një nga këto është dhe kulti i gjarrit apo dragoit që me vendim të këshillit të Bashkisë të Pogradecit u shpall "Monument kulturore dhe simbol i qytetit". Kjo figurë monumentale është gjetur në pafkën e argjendit në varret e Selcës së Poshtme, pra në Pelion. Në këtë pafkë është rafagur Kademi, fjalë kjo që vjen nga pellazgishtja, nga rrënja "dhëmb" pra "d" në atë kohë quhej "dh". Në shqip ekziston shprehja ose mbase pyetja "ka dhëmbë" që do të thotë "a ka fuqi" që pra është i fortë. Mandej për këtë ekziston dhe miti i muzave, të cilat në vite prehistorike që në udhëtime duhej të kishe dy karakteristika, heroizmi dhe dija cilësi këto që Kademi i zotëronte më së miri. Jo vetëm kaq por në atë kohë ekzistonte dhe miti tjetër, pra cilësira të tjera që duhej të përveçoheshin zgjuars, kujtesë dhe shkathtësi, cilësi këto që Kademi i kish përveçësuar në mënyrë të përkryer.

Kademi ishte një pellazg i zonës ilire e që udhëtoi në gjithë botën dhe që pa shumë qytetërim e mjaft elemente i transportonte në Tebe ku gjendeshin bashkatdhetarët e tij haronët. Kademi udhëtoi që sipas mitit fitoi mbi popujt vendas jadët dhe haonët. Të fundit bënë aleancë me Kademin, ndërsa Jadët emigruan. Sipas hulumtimeve të bëra përsipërshkruar del se haonët janë sinonime të haonëve ilirë që quheshin kështu nga që banonin pranë lumit Hao pra sot lumi Shkumbin. Pra kemi një lidhje tjetër të Kademit me Ilirinë. Atje ai u martua me Harmoninë, term ky që do të thotë: ndërthurje, bashkëjetesë e pjesëve të ndryshme. Emri i saj nuk është fare rastësisht, por gjendet në harmoni të plotë me jetën dhe veprën e Kademit. Çifti i ndritur Kadëm-Harmoni lindën një djalë e që i vunë emrin Ilir, i cili do të konsiderohet emërshënës dhe lindës i Ilirisë, paraardhës të Shqipërisë. Kademi vret në zonën e Desereteve dragoin e Kroit Arian e sipas mitit me që atje nuk kishte banus, mbolli dhëmbët e dragoit nga të cilët mbinë burra të armatosur deri në dhëmbë dhe kërcënues të quajtur "të



VERA

PJESË E PANDARË E QYTETËRIMIT

Nga LLAZI TONA

mbirët". Në pleqëri si pellazg i vërtetë do të lërë frymën e tij të fundit në Iliri e u varros në një nga pesë varret monumentale të Selcës së Poshtme.

Ilirët kanë njohur dhe kulturën e vreshtarisë dhe verëtarisë. Ata kanë pasur dhe një koleksion kultesh disa skulptura dhe relieve si në Durrës, Apolloni, Bylis, Orikum, në Lin të Pogradecit etj. gjatë gërmimeve arkeologjike në Lin janë gjetur disa mozaikë me vile rrushi si dhe shumë enë ku ruhej verëtaria e zbkuruar me vile rrushi si dhe me njerëz, që mbajnë kupa me verë.

Përpara shpikjes së bucelave dhe vozave prej druri, vera në Pogradec ruhej, transportohej e tregtohej me shtëmba, me enë të mëdha prej balte dhe pjekur mirë. Nga ana e brendshme ato lyheshin me rrëshirë pishe për të shmangur avullimin e tepërt të verës. Rrëshira, verës i jepte shijen e veçantë. Për përdorim të përditshëm e verës, ajo ruhej në shakull prej lëkure bagëtish të imta dhe këto jepnin shije përkatëse.

Romakët verën e përzienin me mjaltë me përpjesëtime 13 me 10 dhe fillonin ta pinin për pak muajsh. Shishet prej qelqi apo damixhane filluan të përdorshin për mbajtjen e verës aty nga fundi i mijëvjeçarit të parë të erës sonë.

Hyu Dionis mendohet se është shpikësi i verës nga rrushi. Ky kult ka qenë shumë i përhapur dhe i fuqishëm dhe vendin tonë. Aristoteli i Madh pra babai i Logjikës përmend një lloj vere të bërë në Iliri që fermentohej me anën e mjaltit, traditë kjo që për fat të keq ka humbur. Mendohet se kjo lloj vere të jetë prodhuar në zonën e Desereteve, term ky nga që në shqip do të thotë: "Mjaltë blete". Burimet e shkruara tregojnë se enkelenasit dhe deseretët që në kohët prehistorike, shquheshin si pijetarë të dëgjuar vere si dhe një pije tjetër të famshme "Sabaja", pra raki që përgatitej dhe ajo nga mjalti.

Deseretët dhe enkelenasit kanë prodhuar vera të mrekullueshme dhe me famë e që kërkoheshin kudo në botë.

Në Ballkan popujt e parë që selitën hardhitë ishin grekët, ilirët dhe thrakasit. Prej këndej hardhitë rrushi dhe vera kaluan në ujëdhësat e Mesdheut. Në shekullin XII-të vreshtaria u përhap në Evropën Perëndimore dhe atë qendrore deri në ven-

det e Balltikut.

Më 2000 sipërfaqja e vreshtave në Shqipëri ka qenë 5577 ha dhe është prodhuar 821000 kv rrush. Pogradeci në vitin 1900 ka pasur 367 ha vreshta dhe ka prodhuar 20580 kv rrush. Ndërsa në vitin 2000 ka qenë 223 ha vresht dhe është prodhuar 20580 kv rrush. Në vitin 2000 Pogradeci ka blerë një sasi shumë të madhe nga Maqedonia dhe Greqia.

Tradita e përpunimit të rrushit në Shqipëri arriti kulmin në vitin 1990 me 23 fabrika, 74 punishte vere dhe raki si dhe 44 punishte të tjera për prodhimin e rakisë. Gjithsej përpunohej 400 mijë rrush nga vreshta dhe pjergulla duke prodhuar 80 mijë hektolitra verë, 36 mijë hektolitra raki e alkool rrushi, 10 hektolitra uthull dhe 500 hektolitra lëng rrushi. Në vitin 1998 u prodhua rreth 1/3 e sipërfaqes së mëparshme të vreshtarisë.

Në shkrimet e shenjta vreshtaria është një simbol për një fushë pune shpirtërore. Sipas Biblës Jezu Krishti dha shëmbëlltyrë e punëtorëve në vreshtari. Zoti do të bekojë të gjithë ata që punojnë në vreshtarinë e tij.

Lulëzimin e vreshtarisë dhe të verërave në Shqipëri e ndoqi rënia në periudhën e Mesjetës që lidhet me luftërat pushtimin, me mërgimet e popullsisë dhe me përhapjen e islamizmit që ndalonte prodhimin e alkoolit.

Nga hulumtimet të bëra në defterët e turkut për vitet 1519 dhe 1580 gjatë regjistrimeve të popullsisë dhe pasurive që dispononte Mokra në ato kohë ku nga 56 fshatra që ka pasur kjo krahinë 46 fshatra nga ato kishin vreshta me sipërfaqe të konsiderueshme. Administrata turke vuri taksa të mëdha në mënyrë të veçantë në vreshtari. Kështu që fshatarët mokrarrë nga që nuk përballonin taksat në vreshtari hoqi dorë nga to.

Goditja tjetër shumë e rëndë për vreshtarinë ishte shkatërrimi masiv gjatë viteve 90-të shekulli XX. Vitet e fundit ka filluar të ecë por fare pak vreshtaria nëpërmjet zigzageve të ndryshme sepse rrushi blihet me shumicë nga vendet fqinjë të Ballkanit.

Pogradecarët vazhdimisht mburren dhe krenohen me verërat e tyre që janë konsideruar si më të mirat si në Shqipëri dhe në Botë. Fan Stilian Noli për aq kohë që ishte kryeministër i Shqipërisë ka

thënë: Sa herë që bëja pritje të delegacioneve të huaja dhe bëja gjithashtu bankete qeveritare verën e merrnim në Pogradec e cila preferohej shumë nga të huajt.

Njeriu i letrave, Mitrush Kuteli, në rrëfimin e tij "Fshati im e pi rakinë" shkruante:

Ka njerëz rakië, aty në fshat, që nxjerr, sikur lodron njëzet lloj rakië rrushi, tridhjetë lloje e më shumë – si t'ua do e bardha zemër. Se si e zien dhe e përzien, si e këndon dhe si e pëshpërit, ajo është puna e tij – se jo më kot është ai përtej hajdut, si shkrimtar dhe unë i mjeri hiç asgjë.

Po na u bë kësaj dite, o shokë, ky fshati im plot kazanë. Kazanë e shtëpi – shtëpi e kazan. Se di që kazanin është mbret më vete e të shikon që lart, si shatërvan, sa mezi ta kthen mirëmëngjesnë.

Mund të kesh ara sa të duash, gështenja sa të lodhesh dhe tregti të rëndë – puna jote – po s'pate kazan numurohesh i fundit në fshat dhe pa nder. Mund të jesh aty në fshat den baba den, po gjithë i huaj je për defter (fletore për llogari) të fshatit. Mokrarr ishe dhe mokrarr je, dhe fjalë s'ka.

Kaq dijta, kaq thashë, tani puno si të duash vetë sa për mjeshër e të zjerit, të mëson puna vet, në s'do të qeshë bota. Pa më s'ta pret mendja, shko e pyet Shuken se ai ka për të thënë si e qysh, sepse nuk bën raki vetëm për ty e mua, por raki dhe për shenjtorët.

Në fshatin tim, a të lumtë goja, i vogli e pi kupën barabar me të madhin: As dridhet, as shembet, as shëmtohet. Rakia e ka këtë të mirë. Pihet ditë e natë qoftë dimër e verë. Njeriu e pi në dimër që të ngrohet, në verë që të ftohet, në pjesën tjetër të vitit që të punojë mirë gjaku. Mos pini raki të dorës së dytë; por raki të vërtetë.

Ky fshati im, o tungjatjeta ka nxjerrë pijetarë të fortë, sa u ka vajtur emri gjer përtej Shkumbinit.

Fshati im o tungjatjeta e pi rakinë me vrull të madh që nga djepi e gjer në varr. Me kupë në dorë lind, me kupë në dorë rron e me kupë në dorë vdes.

Vera është një pije ushqimore, mbrojtëse dhe shëruese për njerëzit. Në shumë vende të botës vera është kult dhe vihet në krye të pijeve. Shpesh herë quhet hyjnore.

Sipas mitologjisë greke Dionisi e shndërroi verën në një vilë rrushi, për të joshur e bërë për vete Erigonën. Duke shenjtëruar Dionisin grekët e moçëm verën e pavdekësuan.

Në përdorimin mesatar vjetor të verës dalin Luksemburgu dhe Franca me 60 litra/frymë, pastaj Italia me 58 litra/frymë.

Në Pogradec nuk janë të paktë njerëzit që verën nuk e pinë, por e hanë, sepse e përdorin çdo ditë sikur kripën, erëzat, qepët, hudhra. Mezja e parë konsiderohet peshku dhe mbasandaj mishi duke e lartësuar dhe vlerësuar dhe vlerat e ushqimit. Todi Peshkatari jep një këshillë të mirë për pogradecarët: Peshku thotë – Më shijo me verë ose më dërgo ku kam qenë. Peshku dhe orizi rriten në ujë dhe duan të vdesin me verë.

Më 1903, në Pogradec, në shtëpinë e S.T. erdhi si mik nga Skrapari A.V. Këtë radhë kishte ardhur për të blerë drithë; pasi ishte në zonë malore dhe nuk i plotësonte nevojat për bukë. Ai iu lut mikut që ta ndihmonte S.T., pasi e dëgjoi i tha:

-Sa cjep keni në tufën e të dhirtave?

-Më se 20 krerë – iu përgjigj A.P.

-Po verë, a keni prodhuar sivijet?

-Rreth 2000 okë, - iu përgjigj A.V.

-Atëherë, ktheu në shtëpi dhe çdo njëdy javë ther nga një çap, për të pasur më shumë mish në familje. Po ashtu, verën mos e shit, por atë ta pini rregullisht në familje. Keni për të parë se nuk do të keni nevojë të blini drithë dhe besoj se drithi që keni do t'ju teprojë. Miku zbaton porosinë dhe për çudinë e tij; doli e vërteta, këshilla që i kish dhënë miku në Pogradec (Anshu.Ve e Vre.) (vijon në faqen 8)

Çiftëzimi i verës me ushqimin ka qenë praktikë te krishterët ortodoksë pogradecarë. Vera kërkon ushqimin që i duhet asaj pra që t'i përshtatet. Njerëzit që shkojnë për t'u drekuar apo darkuar nëpër restorante fillimisht zgjedhin dhe porositen verën dhe pastaj ushqimin. Sa më e rëndë e plot shije të jetë ushqimi aq më truplot të jetë vera që atë e shoqërojnë.

Në Pogradec parapëlqehet vera e prodhuar në shtëpi sepse është më e njohur, pa hile, me bindje se përmban vetëm lëng rrushi pa përdorime me përpunimin e verës të kimikateve dhe lëndë të tjera që dëmtojnë organizmin e njeriut. Nuk janë të pakta familjet qytetare që prodhojnë verë artizanale shtëpiake me kënaqësi, për të shtruar në tryeza edhe për miq e të afërm pije të mirë, me shije e të këndshme. Të krishterët ortodoksë pogradecarë e kanë përdorur prej shumë kohësh verën, në lindje, në fejesa, martesë, gosti, festa fetare, zyrtare e kombëtare në pagëzime e kungime.

Të krishterët ortodoksë pogradecarë e kanë përdorur prej shumë kohësh verën, në lindje, fejesash, martesë, gosti familjare, festa familjare, fetare, zyrtare, kombëtare, festa shenjtore etj.

Vlera e verës nëpër këta ceremoni; shumëfishohet sepse ajo pihet në shoqëri, miq, krushqi të afërm etj. Këto nuk mund të përfytyrohen pa pije në mënyrë të veçantë verën. Dhe natyrisht si zor të gesh një kombinim më të mirë se sa janë lidhja e përgjithshme: Vera dhe kënga, vera dhe vallja që janë si mishi me kockën. Vëshitë të gesh se kush është parësore, e kërkon vera këngën apo kënga kërkon verën.

Përdorimi i verës nëpër festa apo gosti të ndryshme është se kjo pije krijon ndjenja, hare, gëzim, kënaqësi, dëshira për kuvendim, të bën më të afërt e të vërtetë, ndihmon edhe për shumë çiltërsi e marrëdhënie më të përzemërta e mirëbesim.

E rëndësishme është që nëpër këto ceremoni të ndryshme të mos teprohet me pijet se e bën njeriun të trishtueshëm e dyshues, deri në përfytyrime e fanitje që ndjell një të keqe. Në këto raste njerëzit mund të humbasin vetëkontrollin dhe arsytimin e duhur, mund të shpërdorojnë ndaj të mirave që kanë dhe, për të keq, të ndryshojnë mënyrat e sjelljes dhe të veprimeve të tyre.

Vera është një pije familjare, prandaj mund të përdoret nga tërë pjesëtarët, nga më i vogli deri tek më i madhi, pra dhe për fëmijët, sigurisht të kufizuar dhe nën kontrollin e prindërve.

Novelisti anglez Alec Nauch, njohës i verërave prej disa brezash në familjen e tij, shkruan se fëmijës i mësohet duke pirë një çerek gote qysh kur është 10 vjeç, gjysmë gote kur është 15 vjeç dhe një gotë kur është 18 vjeç...

Disa familje pogradecare kryesisht krishtere ortodokse mëngjeseve të ftohta gjatë dimrit fëmijëve u jepnin përshesh me verë me bukë të thërrmuar në vend të qumështit. Arsyeja është se ato merrnin më shumë kalori e nxehtësi për të përballuar të ftohtit.

Vera ndikon shumë për shëndetin e njerëzve, në mënyrë të veçantë për parandalimin e disa sëmundjeve të rënda të zemrës. Ajo ndihmon për uljen e viskozitetit të gjakut, hollimin e tij, pengon yndyrnat në enët e gjakut dhe, për pasojë, ullet përmbajtja e kolesterolit. Nuk janë të pakta mjekët që shpesh këshillojnë: "Mos e ndani verën nga ushqimi se ajo e bën gjakun të mirë".

Profesor Vangjel Zguro, pranë të cilit kreu një kurs avancimi për derëtarë, midis shumë këshillave që jepte për të kishite edhe këtë: "Vera është ushqim bazë për rruazat e kuqe, ato të bardha dhe muret që ndajnë njerën nga tjetra në zemër. Kushdo që shkon te mjeku për t'u vizituar, ai të çon në laborator të bësh analizat e gjakut kryesisht për gjendjen e rruazave të kuqe apo të bardha.

Por kush qe ky?



MENDIME TË NJERËZVE TË SHQUAR PËR VERËN, VLERAT DHE DOBITË E SAJ

"Vera të ngazëllon, të trishton, gjallëron të moshuarin, frymëzon të riun, të lodhurin e bën të harrojë mundimin" (Lord Bajron)

"Pesë cilësi të cilat me përparësi i lavdërohen verës: Fuqia, bukuria, amësimi, freskia dhe vallëzimi i saj" (Johu Harington 1561-1612)

"Cili është përcaktimi për verën e mirë: Pija e saj fillon dhe mbaron me një buzëqeshje". (Shekspir)

"Vera e mirë është një krijesë familjare e mirë nëse përdoret mirë". (Shekspir)

"Zgjidh ushqimin që përshtatet, shkon me llojin e verës". (Aleksandër Dyma)

"Më shumë filozofi gjendet në një shishe me verë sesa në disa libra". (Lui Paster)

"Vera është jetë"

"Vera hap dijen e zemrës"

"Vera nxjerr në dritë të fshehtat e mëdha të shpirtit". (Horaci, poet romak)

"Të mbash verë në gojë, do të thotë të shijosh një pikë nga lumi i historisë së njerëzimit". (Clifton Fadema)

"Jetesën e përditshme, pirja e verës e bën më të lehtë, më pak të shfrenuar dhe me shumë lëshime". (Benjamin Franklin, burrë i shquar amerikan)

Prof. Vangjel Zguri (1942-2003) ka punuar e drejtuar me prirje e aftësi profesionale për 8 vjet në kantinën e verës në Durrës e Tiranë dhe për më se 30 vjet në Institutin e Kërkimeve të Ushqimit Tiranë. Është kryetar i Shoqatës Kombëtare të Vreshtarisë dhe Verëtarisë.

Nuk duhet harruar dhe agronomi i shquar Dhimitër Nasi (1912-1985). Studioi në Francë për pemëtarë e vreshtari. Gjatë vitit 1937-1943 ishte specialist i vreshtarisë në rrethin e Pogradecit, mandej internohet nga nazistët dhe rikthehet në Shqipëri më 1948 e drejtoi vreshtarinë në Kir-rrethinat e Shkodrës deri në vitin 1951. Ndërsa për më se 20 vitet e fundit iu përkushtua vreshtarisë në Korçë. Ja disa nga këshillat e tij për verën.

"Vera e mirë lavdëron dhe himnizon veten".

"Vera në vresht prodhohet, në vozë ruhet dhe në bardhak pihet".

"Vera është gjysmë ushqimi" e tjerë.

Edhe i vëllai Dhimitrit Enelogu Thoma Nase ka dhënë një kontribut të madh në fushën e verëtarisë për më se 30 vjet me prirje dhe aftësi ringriti tërë kantinat e verës në tërë Shqipërinë njëkohësisht autor i verërave të ëmbla.

Nuk mund të lesh pa përmendur prof. Petraq Sotiri i lindur në Korçë dhe punoj me përkushtim në vreshtat e Lushnjës (1958-65), eksperimentoi dhe ligjëroi në Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe autor i 50 libra në fushën e vreshtarisë dhe verëtarisë.

Vreshtaria – verëtaria tradicionale pogradecare, vazhduese e qytetërimit ilir, deri në ditët tona u ruajt dhe u përmirësua nëpërmjet selitjeve mjeshtrërore të hardhive, prodhimit të verërave dhe rakive. Nuk janë të pakta specialistët e talentuar të Pogradecit në prodhimin e verërave me cilësi të lartë dhe shije të këndshme që preferohet si brenda vendit dhe jashtë tij.

Të tillë janë: Naun Pasko, Thoma Mato, Thanas Kosta, Balash Shuke, e tjerë. Këta mjeshtrë të talentuar kanë punuar

me përkushtim për dhjetëra vite në fushën e vreshtarisë dhe verëtarisë e të pajisur me kulturë e teknologji evropiane duke gërshtuar dhe me kulturën tradicionale pogradecare.

Vreshtarë dhe verëtarë më të mirë në Pogradec kanë qenë: Vasil Nunci që e thërrisnin Coka, Spiro Bendo, Fani i Naços, Jovan Binishi, Tushi Pasko, etj. Vlen për t'u përmendur Vasil Nunçi (Coka) i cili merr pjesë konkursin ndërkombëtar zhvilluar në Bari të Italisë më 1937. Ndërsa në konkursin kombëtar shqiptar më 1940 shpallen fitues të çmimit të parë vreshtetarët – verëtarët Vasil Nunçi (Pogradec) dhe Lisce Peldushi nga Bajza (Mbishkodër) të cilët prodhuan verërat më të mira me rrushin e vjelë nga përkatësisht 0,8 dhe 0,6 ha rrush.

Më 11-12 dhjetor në Pogradec zhvillohet: FESTA E VERËRAVE". Vendi i organizimit të festës është: Rruga "Naim Frashëri", sheshi përpara "Shtëpisë së Oficerëve", sheshi përballë Pallatit të Kulturës "Lasgush Poradeci". Në to ekspozohen lloje të ndryshme të verërave, të shoqëruara dhe me ushqime të përshtatshme për ato.

Gjatë dy ditëve të festave të verës organizohen dhe aktivitete kulturore si koncerte me këngë e valle, shkëmbehen urime së bashku me ambientet e festës. Në hollin e kinemasë "Milenium" kryhet degustimi i verërave nga një komision i posaçëm me specialistë nga më të mirë që ka Pogradec për prodhimin e verërave të cilët shpallen çmim të parë dhe të dytë të verës. Gjatë këtyre dy ditëve festive në Bibliotekën "Mitrush Kuteli" bëhet dhe promovimi i librave, lëvizje e lirë në ambientet e festës, panairt artizanale dhe prodhimeve të dorës. Në mbarim të festës bëhet ndarja e çmimeve për fituesit. Gjatë këtyre viteve të fundit kanë marrë çmim të parë të verërave në Pogradec: Bala Shuke, Naun Pasko, Llazi Tona, Artur Blaceri e tjerë.

Shkruar në Pogradec në Nëntor, 2008



Brahimi e Lule Bardho, prindër të nderuar në Stranik

Në se duam një shoqëri demokratike të edukuar këtë problem duhet ta shikojmë që në familje në fëmijët tanë. Problemet e familjes fillojnë që në çerdhe dhe përfundojnë deri në mbarimin e shkollës.

Shteti dhe shoqatat e ndryshme në këtë drejtim janë duke bërë një punë të madhe. Kudo puna e mësuesve kanë lënë gjurmë të mëdha në edukimin dhe kulturën atdhetare. Pikërisht në këtë fshat punoi i ndjeri mësues Rexhep Kurti i cili nuk është midis nesh. Brahim Bardho thotë: ruaj kujtimet më të mira për atë mësues. Në vitin 1966 jam martuar me Lulen. Kemi lindur e rritur 7 fëmijë: Besimin, Lefterin, Marjetën, Artën, Fluturën, Ardjanin e Adelinën që të gjithë të martuar e me arsim të mesëm. Me edukimin tonë thotë Brahim fëmijët nuk na kanë sjellë asnjë shqetësim. Jemi shumë të kënaqur. Kemi punuar me përkushtim, vetëm e vetëm t'i rritim dhe t'i përgatitim për jetën ashtu si çdo prind. Dhe këtë e kemi arritur edhe pse kemi pasur vështirësi ekonomike, por me sakrificat e kemi përballuar.

Brahimi ka qenë usta ndërtimi, sot pensionist. Zanatin e tij ua ka dhënë Besimit dhe Ardjanit. Duarte e tyre janë të arta. Këtë e shikojmë në shtëpitë e tyre e kudo ku kanë punuar e punojnë. Sot Ardjan punon në ndërtim në Greqi. Me fillimin e demokracisë në të gjitha fshatrat e komunës të Stravajit janë ndërtuar rrugë automobilistike. Çdo shtëpi është furnizuar me ujë të pijshëm. Në Stravaj po ndërtohet hidrocentrali që do të furnizojë me drita disa krahina dhe fshatra. Nëpërmjet këtij shkrimi dua të përshëndes kryetarin e komunës Z. Ardjan Zeneli që punon me një përkushtim për banorët e tij për t'ua bërë jetën sa më të mirë.

Z. Brahim e zj. Lule Bardho ju urojmë pleqëri të mbarë me fëmijët e tyre të mrekullueshëm.

Islam Balliu – Manastirec

Gostivari, "qyteti i gostive,"

Nga Zabit ÇUKU

Sipas dokumentit të vetëm nga epoka antike tek historiani Tit Livi (59 p.e.s 17p.e.s) thuhet se mbreti i fundit i Maqedonisë Pasai (179-163) me 10 000 ushtarë pas pushtimit të Uskanës (Kërçovës) pushton qytezën DrauDAK që më pas të pushtohet Oneji (Tetova). Nga këto të dhëna mund të kuptohet se qyteti i vjetër DrauDAK i cili ka psur rëndësi të madhe, është gjendur në mes të Kërçovës dhe Tetovës d.m.th. Gostivari i tanishëm.

Sipas një legjende emri i tashëm i qytetit është emëruar në kohën e sundimitarit Vukashin edhe atë GOSTIMYSAFIR. Meqë ka pasur një numur të madh të vizitorëve, miqëve nëpër këto vise edhe gjatë periudhës së sundimit të turqëve në turqishte vendin e kanë thirrur "GOSTIVAR,, (miq ka). Vetë emiri Gostivar quhej vendi i tubimit të miqëve "Qyteti i miqëve". Në vitin 1850 gjeologu dhe balkanologu Ami Beu në përshkrimet për Tetovën në mes të tjerave në një pjesë thotë se në Pollog gjendet " fshati i madh" Gostivari, ndërsa si qytet Gostivari për herë të parë është përmendur në dy shkrimet e shekullit të XIX. Sipas tyre ky vendbanim i Pollogut ka formuar çarshinë e vet (qendrën) kurse e marta ka qënë ditë pazari. Në vitin 1874 qyteti ka pasur 400 shtëpi, rreth 2000 banorë, ndërsa në fund të shekullit të njëjtë 3500 banorë.

Bazuar në shkrimet e Abdylahqim Doganit, Gostivari merr emrin nga vajza e ardhur nga Tivari që për vendbanimin ka zgjedhur këtë qytet.

Në gjuhën lokale vajza është gocë edhe ajo nga Tivari, prandaj del emri Gostivar nga goca e Tivarit. Qyteti i Gostivarit gjendet nëpër anale historike nga historianë në zë të cilët japin të



Nacionaliteti	Numri	Përqindja
Shqiptarë	54038.....	66.6 %
Maqedonë..	15877.....	19.5 %
Turq.....	7991	9.8 %
Romë	2237	3.8 %
Vllehtë	15.....	0.01 %
Serbë.....	160.....	0.19 %
Boshnjakë.....	39.....	0.04 %
Të tjerë	685.....	0.84 %
GJITHSEJ	81042.....	100 %

dhëna të rëndësishme për ekzistencën, strukturën e tjera, që vëretet edhe në të dhënat statistikore që i jep etnologu bullgar Vasil Kincev, sipas të cilit në Gostivar në fund të shekullit XIX ka

pasur 3735 banorë, 3180 shqiptarë, 310 të krishterë (maqedon, serb) 200 romë (cergë), 20 turq dhe 25 vllëh.

Ndërsa sot statistika e Gostivarit është si me sipër.

UJI BEKUAR NË POGRADEC

Pak histori për Ujin e Bekuar

6 Janari ka hyrë në histori si Festa e Ujit të Bekuar dhe festohet çdo vit në gjithë Shqipërinë. Veçanërisht në Berat kjo dite merr përmasa të një feste të jashtëzakonshme. Ndryshe konsiderohet si e kremtja (festa) e Theodorisë ose Epifanisë. Midis të dyjave besimtarët kanë parapëlqyer emërimin Uji I Bekuar, kjo jo ditë është një prej të kremteve më të mëdha të kishës Ortodokse dhe preceptohet si shfaqja e perëndisë në botë, pra si Trini (një qenie e vetme në tre persona; Ati, Biri e Shpirti I Shenjtë), në momentin e pagëzimit të Jezu Krishtit, Birit të Prendisë të bërë njeri. Të krishterët besojnë se qysh kur Biri i Prendisë të bërë njeri. Të krishterët besojnë se qysh Biri i Prendisë mori mish njerzor dhe u zhyt në ujrat e Jordanit, i tërë materiali u shenjtërua dhe u pastrua në të, u la prej cilësive të saj, që kishin të bënin me vdekjen, të trashëguara nga I ligu dhe nga dobësia e ligësia e njerzëve. Pra, kjo festë është shprehja e faktit më qëndror të vizionit të krishterë për njëjtimin si dhe për jetën e botës së tij. Shenjtërimi i ujit vërtetohet sot nga të krishterët, të cilët në çdo 6 janar mbushin ujë të bekuar, i cili qëndron i freskët deri 6 janarin e vitit tjetër njerzore.

POGRADEC

Rreth 10 mijë qytetarë pogradecarë u drejtuan në mesditë në drejtim të molit të qytetit, ku u zhvillua ceremonia e përvitshme e ujit të bekuar. Ceremonia u shty më se dy orë për shkak të vonësës së metropolit të Korçës. Edhe pse temperaturat arinin në disa gradë nën zero qytetarët kanë pritur derisa u zhvillua ceremonia. Më pas imzot Joani ka bekuar ujin e liqenit dhe ka hedhur kryqin. Qënë rreth 30 të rinj që u zhytën në ujrat e akullta të Liqenit. Kryqi u kap nga 18 vjeçari Kristi Nikolla. Më pas qytetarët mbushën shishe me ujë të bekuar për në shtëpitë e tyre.

AGJENTURA JUGOSLLAVE NË POGRADEC (1924-1944)

(Dokumenta të Arkivit Qëndror-Shqiptar)

Akte diversimi: Më 17 mars 1924 nënprefekti i Pogradecit, Zef Kadareja, kishite thirrur të dorëzuarit të planifikuar për akte diversioni nga jugosllavët. Hekuarn Xhaferi nga Zagorçani në Ohër e kishite thirrur Hajdar Zagorçani, i cili kishite thënë të shkante në Mborje, ku kishite komitë bullgarë, ishte vënë detyrë nga konsulli jugosllav i Korçës, ku ishin mbledhur më 10 mars 1924. Hajdar Zagorçani ishte i arratisur kriminel.

Më 18 prill 1924 pas gjurmimit arrestohet Hysen Hasan Struga, dhe Stanoje Simiç, konsulli jugosllav i Korçës, interesohej e kërkon ta takojë duke mëtuar se ai ishte shtetas jugosllav. (AQSH, F 152, viti 1924 (Zogu), D.21 fleta 1-45)

Më 9 tetor 1930, Prefekti i Elbasanit, Qazim Bodinaku, dërgon listat e shtetasve jugosllavë (huaj) që banonin në këtë qark, të cilët banonin në disa fshatra të Qukësit, Martaneshit, Librazhd, të cilët ushtronin profesionin e tregëtarit, si bakej e hanxhi. Ata bënin spinazhe, dhe prefektura propozonte largimin e tyre. Lista përbëhej nga 24 persona, pergjithësisht tregëtarë me banim në Bërzesh të, Qukës, Rrajcë, Martanesh, Librazhd, të lindur kryesisht në Strugë, Belic, etj. (AQSH, F

152, viti 1930 (Zogu), D.86 fleta 1-3)

Zevendës prefekti i Korçës, Tasim Bishqemi i përcolli më 29 maj 1930, njofton se konsulli jugosllav ka shkuar në Pogradec më 26 maj 1930, për të marrë vesht mënyrën e regjistrimit të disa familjeve prej katundeve Balicë të Jugosllavisë që banonin në Pogradec me emrat Pashko Vesho e Spiro Vesho nga Belica dhe Qiro Drisoni nga Ohri. Ata ishin regjistruar si shtetas shqiptarë, për shkak se kanë shumë vjete që merren me tregëti në Shqipëri,, (AQSH, F 152/13, viti 1930 (Zogu), D.168 fleta 16).

Zyra Sekrete më 25 shkurt 1929 e Prefkturës së Korçës se Azis e Yzeir Goroshishti prej Pogradeci ose Starove ishte agjenti jugosllav dhe endej në buzë të kufirit, kërkoheshin hetime.

Më 12 shtator 1932 Preefturës Korçës i kërkohet t' i kishite nën gjurmimin të imët 17 persona si agjentë jugosllavë, që ishin nga Velçani, Lakteshi, Çezma e Madhe, Gora, Pogradeci, Alarupi, etje. (AQSH, F 152/15 viti 1932, D.50/1 fleta 119).

Kishite edhe të tjerë që kërkoheshin të prishnin regjimin, nga Korça, Elbasani (Rrajca). Kryetarët e komitetit që ndodhen në jugosllavi etikoheshin Nerim

Starova, Kajo Jonuzi, Demir Poloska, Kipi Alaraku, Hasan Struga. Në vijim të informacionit, më 8 nëntor 1932, prefektura e Korçës njoftonte të dhënat për personat që kërkoheshin të ndiqeshin.

Më 19 tetor 1932, nënprefekti i Pogradecit Is'han Libohova njofton se më 12 korrik 1932, Rasim Ali, Nevruz Starova kanë shkuar në Korçë, ku kanë takuar Ahmet Demin për të formuar degën e komplotit të Vlorës, duke ardhur më pas në Pogradec, ku në shtëpinë e Rasim Aliut, kane zhvilluar mbledhjen themeluese, ku kishin ftuar edhe Xhavit Dervish Starovën, si dhe Hysen Qerimin, nga Starova. Raporti është kritik edhe ndaj deputetit Sulajman Starova. (AQSH, F 152/15, viti 1932, D.50/1 A fl faqe 398).

Më 24 qershor 1939 zevendës prefekti dhe zevendës kryetari i bashkisë Tiranë, Banush Bego, ankohej se pensioni i tij kishte qënë 375 franga ari në muaj, ndërsa atë cast ai merrte 236 franga ari, dukje kërkuar të paguhej nga fondi secret. Më 28 qershor 1939 Bego njoftonte shpenzimet që duhej të bënte duke përfshirë pagën e tij prej 700 franag ari dhe të dy informatorëve me 110 fran-

Më 1 shkurt 1944, ministri Xhafer Deva i dërgon një letër Komitetit Qëndror të Ballit Kombëtar, duke i thënë se drejtuesit e saj po mblidhnin ndihma kolosale për organizatën, madje duke u kërkuar edhe nëpunësve shtetërore, deri në forma kërcënuese një gjë të tillë. Kjo gjë quhesh e parpanueshme per dinjitetin e shtetit, dhe Deva kërkonte ndalimin e kësaj gjeje.

Dy ditë më vonë komandanti i pergjithshëm i xhandarmërisë kolonel Hysen Dema i shkruan zyrës politike, se një fuqi balliste e Isak Allës në Librazhd kishite zbuluar fuqinë e partrullës së Xhandarmërisë. Sipas tij Alla nijhej si njeri plaçkitës, ku përmendet vjedhja e SAIDE, me dymijë franga. Mirë Gjickën. Një gjendje e tillë, sipas Demës, vihej re edhe në zonën e Shijakut. Më 11 shkurt 1944, Hysni Dema njoftonte se një fuqi gjermane dhe balliste ishin vënë në ndjekje të Myslim Pezës. (AQSH, F 152, viti 1944, D.198, fleta 1-24).

Më 22 shkurt 1944, kolonel Hysni Dema, shkruan për Isak Allën e Haki Blloshmin, i kishin venë vetes kompetenca, që i shtronte auteritetin, qeveritar. Në të gjithë postblloqet, ballistët nuk ia lëshonin xhandarmërisë.